REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 50/17
Date/Datum 04.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. **50/17**

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, nenit 106, si dhe nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej, z.Nuhi Paçarizi - Kryetar, z.Tefik Sylejmani - Referues dhe z. Blerim Dina - Anëtar, mbi shqyrtimin e përgjegjësisë së autoritetit kontraktues - Komuna e Dragash, lidhur me mos zbatimin e vendimit të PSH-së nr. 263/16, vendimin nr. 334/16 dhe Urdhëresen me nr. 423/16, pas ankeses së operatorit ekonomik "Puna shpk & K-ing shpk", me seli në Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i ujësjellsit në Dragash - vazhdimi i punimeve"**, me nr. të prokurimit 621/2016/031/521, më datën 20.03.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **Gjobitet**, autoriteti kontraktues / Komuna Dragash, konform nenit 131 të LPP-së, për mos zbatim të vendimit nr. 263/16, nr. 334/16 dhe Urdhëresen nr. 423/16 të datës. 27.12.2016, në shumë prej 5,000.00 € (pesë mijë euro).

II. **Urdhërohet**, autoriteti kontraktues / Komuna Dragash, pas pranimit të këtijë vendimi, të bëjë pagesën e gjobës në xhirollogarinë e Organit Shqyrtues të Prokurimit: Nr. **1000 4300 7000 5756 / Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.**

III. Operatorit ekonomik ankues: "Puna shpk & K-ing shpk" - Prizreni, i bëhet kthimi i sigurimit të ankesës. I njejti OE, obligohët që në periudhën kohore prej më së largu gjashtëdhjetë (60) ditësh të parashtroi kërkesë për tërheqje të mjeteve, në të kundërtën mjetet do të transferohen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik "Puna shpk & K-ing shpk", me seli në Prizren, më dt. 21 shkurt 2017, ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK – Komuna Dragash, ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 59 dhe 62, të LPP-së, si dhe nenit 44, të rregulave të UOPP-së, ndërsa përmes deklaratës në ankesë potencon se AK – Komuna Dragash, nuk e ka zbatuar Urdhëresen e OSHP-së, poashtu kërkon nga OSHP, që sipas nenit 131, të LPP-së, të shqiptoj gjobë ndaj autoritetit kontraktues.

Me rastin e procedurës para këtij organi u prezantuan provat duke e bërë kontrollimin dhe analizën- shqyrtimin e materialit të këtij aktiviteti të prokurimit i cili përbëhet nga: vendimi i nr. 263/16, i datës. 06.09.2016, vendimi i nr. 334/16, i datës 24.10.2016, urdhëresa e nr.423/16, e datës 27.12.2016, ankesa e datës 21.02.2017, me nr. 50/17, kopja e shkresës elektronike - plotesimi i ankesës i datës 23.02.2017, si dhe raporti kronologjik i datës 03.03.2017.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, raportit kronologjik si dhe shkresat e lëndës të këtijë aktiviteti të prokurimit konstaton se AK – Komuna Dragash, nuk ka respektuar – zbatuar urdhëresën e PSH-së, Nr.423/16, e datës 27.12.2016, për zbatim të vëndimit nr. 263/16, të datës. 06.09.2016, dhe vendimit nr. 334/16, të datës 24.10.2016. Andaj paneli shqyrtues konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së, vendos gjobë ndaj AK – Komuna Dragash, të përshkruar si ne piken 1, të dispozitivit të këtijë vendimi, për mos zbatim të urdhërit, gjegjësisht konform nenit 25 pika 8 e LPP-së, konstatohet se kemi të bëjmë me shkelje të rëndë të LPP-së në fuqi si dhe shkelje të rregullave të prokurimit, nga zyrtari përgjegjës prokurimit, për bishtrim - shmangëje të përmbarimit të vendimeve të nxjerra nga OSHP.

Paneli shqyrtues konstaton se përkundër përshkrimit, tek vendimi për miratimin e buxhetit të komunës së Dragashit, për vitin 2017, dhe vleresimet për vitet 2018 dhe 2019, gjegjësisht tek tabela: 4.2 Financimi i investimeve kapitale komunale – Planifikimi urban – "Ujesjellesi Kryesor – Vazhdimi i Punimeve per vitin 2017, ku është e përshkruar vlera prej 327,250 €, e dërguar përmes shkresës elektronike (e-mailit), si plotësim i ankesës, ku parashtruesi i ankeses, OE "Puna shpk & K-ing shpk", pas urdhëresës nr. 423/16, e datës 27.12.2016, Organi Shqyrtues i Prokurimit, i ka ndërmarr të gjitha veprimet ligjore të parapara sipas LPP,
Ndërsa parashtruesi i ankesës mund t'u drejtohet organeve tjera kompetente per realizimin e të drejtave te tij te parapara me dispozita ligjore.

Andaj bazuar në nenin: 131 të LPP-së dhe atë qe u tha si me larte, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur
nuk mundë të ushtron ankesë,
për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh,
pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë
kërkesëpadi në Departamentin për çështje
administrative
pranëGjykatësThemelore.

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues
z. **Nuhi Paçarizi**

Vendimi t'i dorëzohet:

1. 1x1 AK – Komuna Dragash
2. 1x1 OE - "Puna shpk & K-ing shpk" - Prizren
3. 1x1 Arhivës së OSHP-së